

BIBLIOTEKA E

SHTETIT

8JH-32

R. 57

GJIROKASTER

KAPLLAN RESULI



Gjarpni

NOVELË

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

R

KAPLLAN RESULI

8SH-32

R. 5+

8SH-32

3

BIBLIOTEKA E SHTËPËRISË  
GUROMASFEC

GJARPNI

(Novelë)

34436  
48925

## NXANËSVE TË MI TETOVARË

për atdhedashuninë e tyne të flaktë,  
për guximin revolucionar  
dhe krenarinë kombëtare.

**Autori**

## PROLOG

Historia e gjarpnit, për të cilin bahet fjalë në këtë novelë, ka ndodhë në ditët tona, në krahinat tona, por përtej kufijve politikë të atdheut tonë. Ajo tash mund të tingëllojë edhe si legjendë. Se legjendë asht për ne shtypja, diskriminimi, padrejtësia, vuejtja, skamja e mjerimi. Mirëpo për vllaznit tonë atje përtej kufinit, në Kosovën martire, edhe sot e kësaj dite, kjo histori asht një e vërtetë jetësore, asht kafshata e idhë e bukës së përditshme që po e kapërdijnë jo vetëm me djersë, por edhe me lot e me gjak.

Unë isha atje dhe e provova në kurrizin tem atë jetë. Jetë i thançin! U rrita e vuejta atje si të gjithë të tjerët. Dhe qëllova në Ulqin kur e ndigjova për herë të parë historinë e gjarpnit. Ishte 1956. Më kujtohet fare mirë, ndonjëse kanë kalue dhetë vjet që nga ajo ditë gushati, kur më treguen për Blerim Metën, që qenka shërue në një mënyrë krejtësisht të çuditshme

e të papritun. Ai banonte në kalanë e Tivarit, aty në mes ullijve dhe blerimit të përhershëm, dhe unë s'pritova të shkoj e të takohem me te. Mirëpo sa u dëshpërova kur më thanë prindët e tij:

— Blerimi vërtet ka qenë shumë i sëmu ndë dhe shumë i talentuem... por... ai ma s'jeton.

M'u duk sikur më ra qelli mbi kokë. Dhe më erdhi keq. Më erdhi jashtëzakonisht keq. U kërkova ndjesë për plagën që pa dashje ua lëndova dhe aq ma tepër që pyeta në atë mënyrë për birin e tyne, tue mendue se ishte gjallë.

Atëhere ata, tue më shikue me trishtim, më thanë:

— Historia e gjarpnit ka ndodhë në Virpazar. I ka ndodhë të birit të Baki Blinit. Ashtu kemi ndigjue. Tash vonë bile. Në goftë se s'gabohemi, djalin e quejnë Jeton.

U nisa për Virpazar, atje në cepin veripe rrëndimor të Ligenit të Shkodrës, dhe e kërkova Jetonin.

Përpara nji kasolleje me kashtë, që tymonte nga të katër anët, më doli baba i djalit, peshkatari plak Baki Blini. Kur e pyeta ku ishte Jetoni, ai më shikoi një çast me habi, mandej ju mbushën sytë me lot.

— Na la Jetoni, bir. S'jeton ma Jetoni, — më tha ai dhe, tue fshi lotët me bërrylat e xha-ketës së vjetër, më tregoi një vorr aty buzë lijenit.

Sytë më gufuen edhe mue, por e përmbajta veten.

Disa minuta ma vonë, kur e pyeta mos dinte gja për historinë e gjarpnit, xha Bakiu shtoi mengadalë:

— Atje në Tuz asht nji djalë. E quejnë Lul Gjoluli. Më kanë thanë se atij i ka ndodhë historia me gjarpnin.

Ndonëse rrugët janë të lodhshme, kureshtja s'më la. Mbas disa ditësh e kërkova Lulin në Tuz. Mirëpo prindët e tij më treguen vetëm librat e djalit dhe më thanë me dhimbje:

— Ai ma kurrë s'do t'i hapë këto libra, që aq shumë i deshte. Vdiq Luli ynë dhe na la shkretë, or mik.

Ndeja nji orë të mirë me prindët e të ndjerit djalë, u përpoqa t'i ngushulloj sadopak dhe mandej i pyeta për historinë e gjarpnit që më kishte çue aty.

— Aha! — banë të shkretuemit. — Historia e gjarpnit ka ndodhë në Plavë, or mik! I ka ndodhë Armirit të Musto Gjobalës.

Shpresojsha me e gjetë Armirin gjallë. Mirëpo Musto Gjobala, kur e pyeta për të bi-

rin, rënkoi thellë, drodhi mustaqet i mërzitun  
dhe më tha:

— Eh, sa bukur i binte ai lahutës! Zogu  
i malit i zbriste në sup dhe e ndigjonte i shas-  
tisun.

Nga Plava e Gucia zbrita në Pejë, ktheva  
në Rozhajë, në Tutin e në Dukagjin<sup>1</sup>). Shkova  
në Mitrovicë, në Podujevë e në Prishtinë. Gji-  
thnji tue ndjekë gjurmat e historisë së gjar-  
pnit, shkova edhe në Gjakovë e në Prizren, në  
Ferizaj e në Kaçanik, në Preshevë, Gilan e Ku-  
manovë. E ku nuk shkova? Ku nuk pyeta? Me  
ke s'u takova dhe çka s'ndigjova? Çka s'pa-  
shë?

Në Manastir nji nanë shkuli flokët nga  
idhними, kur i kujtova të birin, që i kishte vde-  
kë nga uja. Në Resën zemra më pikoi gjak, tue  
shikue fotografinë e vogëlushit Dashnor Shpe-  
ndi, ndërsa në Ohër e në Strugë qava edhe unë  
me prindët e Artës e të Artanit, se s'isha ma  
në gjendje me u përmbajtë.

Mandej shkova në Dibër, në Kërçovë e në  
Gostivar. Shkova edhe në Shkup, por kot.

Mbas disa muejsh u emnova arësimtar në  
Tetovë. Aty takova nji mësues, që më drejtoi

---

1) Dukagjin — qytetin e Dukagjinit tash, e quejnë Jeni-  
pazar, Novi Pazar dhe Tregu i Ri.

te Astrit Luboteni, në mëhallën e Muharrem Nallbanit, karshi Çarshisë së Epërme.

U nisa pra edhe këtë herë, disi si pa qejf e i lodhun, me dyshim. Mirëpo sa u gëzova kur hapa derën e avllisë dhe në oborrin e një shtëpie të vjetër, përdhese, siç i thojshin andej dojmallije, pashë nji djalë të ri, që i kishte apo s'i kishte nandëmbëdhetë pranvera. Zemra më rrahu fort dhe e ndjeva se ky do të ishte Astrit Luboteni, njeriu që kërkojsha prej kohësh, qytet më qytet e kasolle më kasolle.

Kur e pyeta, djaloshi sykaltër më tha:

— Po, unë jam Astrit Luboteni.

Zani i tij, ai za aq i ambël, aq i butë, aq i pastër e melodioz, edhe tash që po e kujtoj, mbas gati dhetë vjetësh, më kumbon në veshë e më ngjall admirim.

U gëzova pa masë që ma në fund e gjeta. E shikojsha me kureshtje, si një njeri të jastëzakonshëm. Dukej mirë me shëndet. Vërtet ishte pak i hequn në fytyrë, por sytë i shkëlqejshin dhe zanin e kishte të kthjellët.

Mbas fjalëve të para që ndërrova me te, kuptova se atë vit kishte krye gjimnazin dhe kishte dalë mirë me mësime, shkëlqyeshëm. Dëshironte me i vazhdue studimet në Shkup, madje kishte zgjedhë edhe degën e mjekësisë,

se ate kishte për zemër ma shumë, mirëpo s'i kishin dhanë bursë, se babën, para pak kohe, ja kishin burgosë për herë të dytë.

— Nuk po mundem me gjetë as punë ndokund, — më tha i dëshpëruem e tue ndryshë grushtat.

Mandej, si u ulëm në bar të njomë, nën hijen e nji dardhe, ai ma tregoi historinë e gjarpnit fill e për pe, ashtu siç do të përpinqem me jua tregue edhe unë juve.

## KAPITULLI I PARË

Vjeshtë e shëmtueme tetovare. Gjethet e pemëve, si të mekuna, pikin nji mbas nji prej degëve, valviten në ajrin e amulluem dhe bien për tokë. Bari nën pemë, i vyshkun e i trishtë, sikur e ka varë kryet e vajton. Herë-herë dridhet si para stuhisë dhe të duket se edhe toka për diçka rrëqethet. Kudo rreth e qark depërtonte zverdhina, nji zverdhinë trishtuese, që të lodhte sytë e të mërziste.

Edhe shtëpitë ishin të lyeme me nji farë ngjyre të verdhë. Vetëm rreth dritareve spikaste nji rryp i ngushtë dërrase, zakonisht i bojatitun me bojë të kaltër. Çatitë e shtëpive ishin të gjana, të ulëta, muret me qerpiq, të ngushtë. Po t'i rrëmojshit me majën e thonit, troshiteshin si dhë. Ndoshta për këtë shkak edhe e kishin strehën e gjanë këto shtëpi, se, sikur t'i rrihte nji shi pak ma i fortë, do të shkriheshin e s'do t'u mbetej as nami as nishani.

Shkumbini i Tetovës, menjiherë, si hyn në